



## Drejtoria e Arsimit

Nr. Prot. **04-188**  
Me dt. 29.05.2024

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 62 paragrafi 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 7 të Rregullore Për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës me numër të protokollit 01 Nr.110/01-3560 të dt.04.02.2020, Drejtoria e Arsimit shpall:

### KONKURS

#### PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË GJAKOVËS

- I. Komuna e Gjakovës ndanë **100 (njëqind) bursa** për studentë të cilët studiojnë në Universitetet Publike të Kosovës për vitin akademik 2023/2024, në këto fusha studimi:
  1. Fakulteti i Arteve – 4 bursa
  2. Fakulteti i Shkencave Sportive - 4 bursa
  3. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës – 10 bursa
  4. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike - 5 bursa
  5. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike - 6 bursa
  6. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë – 2 bursa
  7. Fakulteti i Mjekësisë dhe Infermierisë - 17 bursa
  8. Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore – 15 bursa
  9. Fakulteti Filologjik - 4 bursa
  10. Fakulteti Filozofik - 4 bursa
  11. Fakulteti Ekonomik - 4 bursa
  12. Fakulteti Juridik - 4 bursa
  13. Fakulteti i Edukimit - 4 bursa
  14. Fakulteti i Shkencave Sociale – 4 bursa
  15. Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit – 2 bursa
  16. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike - 6 bursa
  17. Komunitetet jo shumicë - 5 bursa

II. Vetëm studentët/et që janë banorë të komunës së Gjakovës, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultete të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës; **duke përjashtuar studentët në studime pasuniversitare – master dhe doktoratë**; kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave të studimeve.

### **III. Kriteret e përgjithshme:**

1. Të kenë regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;
2. Të mos jenë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër ose të jenë të punësuar;
- 3. Të mos jenë përsëritës të vitit akademik;**
4. Të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomike-sociale të familjes;
5. Studentët që janë regjistruar për herë të parë në fakultete, duhet të kenë dëshminë e suksesit të shkollës së mesme.

### **IV. Kriteret për ndarjen e bursave janë:**

- a. Nota mesatare prej 9 – 10 në fakultete ose sukcesi i shkëlqyeshëm ..... (20) pikë
- b. Nota mesatare prej 8 – 9 në fakultete ose sukcesi shumë i mirë ..... (15) pikë
- c. Nota mesatare prej 7 – 8 në fakultete ose sukcesi i mirë ..... (10) pikë
- d. Rastet me gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale . ..... (20) pikë
- e. Fëmijët pa prind..... (20) pikë
- ë. Personat me aftësi të kufizuara..... (15) pikë

Në kushtet e barabarta të vlerësimit të kriterëve, përparësi kanë fëmijët e dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve të luftës dhe familjeve që kanë dy apo më tepër studentë.

### **V. Dokumentet e nevojshme të domosdoshme për aplikim:**

1. Aplikacioni sipas formës së Komunës;
2. Kopja e ID-ës së studentit;
3. Kopja e letërnjoftimit;
4. Ekstrakti i lindjes;
5. Deklarata e bashkësisë familjare;
6. Vërtetimi se studenti ka regjistruar vitin akademik 2023/2024, sipas vitit të aplikimit për bursë (origjinale);
7. Certifikata e notave (origjinale);
8. Vërtetimi që studenti nuk është përfitues i bursës nga Universiteti apo MASHTI;
9. Certifikata / Diplomave për përfundimin e shkollës së mesme të lartë (kopje). Çdo aplikacion në mungesë të këtij dokumenti konsiderohet se nuk është banor i Komunës së Gjakovës për më tepër se 10 vite;
10. Vërtetimit nga Administrata Tatimore që nuk jeni në marrëdhënie pune;
- 11. Për anëtarin e ngushtë të familjes së dëshmorëve:**  
Vendimi / Vërtetimi se është anëtar i ngushtë i familjes së dëshmorëve;
- 12. Për anëtarin e ngushtë të familjes në asistencë sociale:**  
Vendimi / Vërtetimi që dëshmon se aktualisht është shfrytëzues i ndihmës sociale (origjinale);
- 13. Për studentët e regjistruar për herë të parë në vitin akademik aplikues:**  
Kopjet e vërtetuara të dëftësive dhe të diplomës për përfundimin e shkollës së mesme;
- 14. Për studentë me nevoja të veçanta:**  
Vendimi / Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

## VI. Afati për aplikim dhe mënyra e dorëzimit të dokumenteve:

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve në Drejtorinë e Arsimit, në mjetet e informimit publik dhe në web-faqen e Komunës së Gjakovës: <https://kk.rks-gov.net/gjakove/>
- Konkursi mbetet i hapur prej dt. **30.05.2024** e deri më dt. **13.06.2024**.
- Aplikacioni i kërkesës merret në Drejtorinë e Arsimit në Gjakovë dhe i plotësuar dorëzohet në zyrën për pranim dhe arkiv në objektin e Komunës së Gjakovës çdo ditë pune prej orës 08:00 deri 15:00.

**VËREJTJE:** Dokumentet e pakompletuara sipas pikës V të këtij konkursi dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

### **Komisioni Vlerësues:**

Përzgjedhja e përfituesve bëhet nga komisioni vlerësues i propozuar nga ana e njësisë kërkuese duke u aprovuar me vendim nga ana e Kryetarit të Komunës. Komisioni vlerësues nuk është organ i përhershëm, por emërohet pas publikimit të thirrjes për aplikim dhe shpërbëhet menjëherë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit. Komisioni vlerësues është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtë dhe listës së përfituesve përfundimtar. **Në rast kur në një profil të caktuar nuk ka aplikues/përfitues të bursës, atëherë komisioni i vlerësimit ka të drejtën e rialokimit (shpërndarjes) të bursave tek profilet me prioritet.** Në përfundim të procedurës së vlerësimit, Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave përpilon një raport/procesverbal të punës dhe të njëjtin e dorëzon tek Drejtori i njësisë përkatëse, i/e cili/a mbi bazën e rekomandimeve nga raporti, ia përcjell dokumentacionin Kryetarit për vendimmartje.

Kandidatëve të cilëve iu ndahet bursa për kushtet e shfrytëzimit do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku do të precizohen kushtet, obligimet dhe detyrat e dyanshme.

Me respekt!

**Drejtori i Drejtorisë së Arsimit**

Eranda Baçi

